

VENDIM
Nr. 677, datë 2.9.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 201, DATË 11.4.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘REHABILITIMI I QENDRËS SË QYTETIT FUSHË-ARRËS’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 201, datë 11.4.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shitesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “njësi”, “apartament” dhe “ndërtesë”, nga 12 004 549 (dymbëdhjetë milionë e katër mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë, ndryshon dhe bëhet 15 121 806 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e një mijë e tetëqind e gjashtë) lekë.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 15 121 806 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e një mijë e tetëqind e gjashtë) lekësh, përballohet nga llogaria ‘Fondi i shpronësimeve’, në Bankën e Shqipërisë.”.

c) Në tabelën bashkëlidhur vendimit ndryshohen të dhënat e pasqyruara në numrat rendorë 12 dhe 13, si dhe shtohen numrat rendorë 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Shpenzimet procedurale me vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Fushë-Arrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 201, DATË 11.4.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I QENDRËS SË QYTETIT FUSHË-ARRËS”

Nr .	PRONAR I	LLOJI I PASURISË	ZONA KADASTRAL E	VOL .	FAQ E	NUMRI I PASURISË	SIPËRFAQ E BANESE DHE NJËSIE	SIPËRFAQ E BANESE DHE NJËSIE QË ZIHET NGA PROJEKTI	ÇMIMI I BANESE S LEK/M²	VLERA E NJËSIVE SIPAS SITUACIONIT	VLERA TOTAL E NË LEKË	SHËNIME
1	Fratel Prendi	Njësi	1656	1	196	2/42-N5	57.93	57.93		1,232,572	1,232,572	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Raiffeisen Bank sh.a	Njësi	1656	2	179	2/42-N3	56	56		1,136,407	1,136,407	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Ndrec	Njësi	1656	1	105	2/42-N2	206	206		4,284,809	4,284,809	Konfirmuar nga ASHK-

	Ndue Qafa											ja
4	Ndrec Ndue Qafa	Apartament	1656	2	181	2/42+5-7	40.5	40.5	7,500		303,750	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Ndrec Ndue Qafa	Apartament	1656	2	180	2/42+2-6	52.13	52.13	7,500		390,975	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Tonin Gasper Pepa (1/3) Marije Ejell Pepa (1/3) Enriketa Pjerin Pepa (1/3)	Apartament	1656	2	186	2/42+1-7	70	70	7,500		525,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Ndrec Ndue Qafa	Apartament	1656	2	187	2/42+1-5	56.6	56.6	7,500		424,500	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	Ndrec Ndue Qafa	Apartament	1656	2	185	2/42+1-4	61	61	7,500		457,500	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	Valentin Gjin Marku (0/100) Vitore Ndue Marku (0/100)	Apartament	1656	2	182	2/42+1-3	57.9	57.9	7,500		434,250	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Angjelin Zef Kakusi (0/100) Pashke Bibe Qafa (0/100) Zef Ndrec Kakusi (0/100)	Apartament	1656	2	183	2/42+1-2	58.3	58.3	7,500		437,250	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	Ndrec Ndue Qafa	Ndërtesë	1656	1	104	2/10-ND	59	59		1,203,782	1,203,782	Konfirmuar nga ASHK-ja
12	Ndoc Bibe Qafa	Ndërtesë	1656	4	250	2/47-ND	46.5	46.5		970,523	970,523	Konfirmuar nga ASHK-ja
13	Llesh Dodë Deda	Ndërtesë	1656	5	2	1/165-ND	8.6	8.6		203, 230	203,230	Konfirmuar nga ASHK-ja
14	Ndue Gjelo Marku Nikolin Gjelo Marku Pavlin Gjelo Marku Tringë Gjelo Marku Prendi Vate Gjelo Marku	Apartament	1656	2	184	2/42+1-1	56.6	56.6	7500		424,500	Konfirmuar nga ASHK-ja me datë 9.4.2019
15	Ndrec Ndue Qafa	Apartament	1656	2	188	2/42+1-6	17.37	17.37	7500		130,275	Konfirmuar nga ASHK-ja me datë 2.4.2019
16	Erjon Ismajil Simoni	Njësi	1656	1	166	2/42-N4	96	96		1,040,952	1,040,952	Konfirmuar nga ASHK-ja me datë 2.4.2019
17	Erjon Ismajil Simoni	Njësi	1656	5	5	2/42-N6	18.15	18.15		256,208	256,208	Konfirmuar nga ASHK-ja me datë 2.4.2019
18	Viktor Ndue Qafa	Njësi	1656	5	10	2/42-N7	37.8	37.8		607,266	607,266	Konfirmuar nga ASHK-ja me datë 2.4.2019
19	Viktor Ndue Qafa	Ndërtesë	1656	56	1	2/43-ND	48	48		658,057	658,057	Konfirmuar nga ASHK-ja me datë 2.4.2019
	SHUMA TOTALE										15, 121, 806	